



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit _ dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga personit juridik, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-2834 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-2834 me datë 13.05.2019, dorëzuar nga parashtruesi – person juridik, nëpërmjet avokatit, nga, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-2834 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-2834 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-2834 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit/informimit nr. 12-2834/1 me datë 23.05.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtrues – person juridik, nëpërmjet avokatit, nga

Në denoncim flitet për akuza kundër drejtorit të një instirucioni publik nacional, përshkak të dyshimeve për afirmim të interesave të veta personale dhe veprave të mundshme korruptive në realizimin e procedurës për furnizim me akulllore për nevojat e Lokalitetit -, si dhe për keqpërdorime të të drejtës diskreditive si drejtor i një institucioni publik gjatë veprimir dhe vendimmarrjes për zgjedhje të ndërmarrjes për blerje të akullloreve nga e njëjta, favorizimi i një ndërmarrjeje dhe kufizimit të të drejtës të ndërmarrjes tjetër për shitje të akullloreve në lokacionin e njëjtë.

Kah lënda me numër 12-2834 nga viti 2019, me arsyje që bëhet fjalë për lëndë që kanë të bëjnë me akuza të lëndës për rastin e njëjtë institucional dhe gjendjes së njëjtë faktike, i është bashkur edhe lënda e vulosur në KSHPK me numër 12-3882 nga viti 2019, e formuar në bazë të kërkesës 12-3882/1 me datë 14.08.2019, dorëzuar nga Ministria e kulturës së RMV, kurse në lidhje me lëndën e formuar pas ankesës deri tek ministria nga ana e avokatit, nga e cila ka qenë e vulosur me numrin e arkivës UPP 53-10 me datë 23.05.2019.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike dorëzoi kërkesë deri tek

Institucioni nacional, për mbledhje të të dhënave, informacione dhe dhe dokumentave në lidhje me akuzat e lëndës. Pas kërkesës së Komisionit shtetëror janë dorëzuar të dhënat dhe informacionet e kërkuara me shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës është vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret, bëhet fjalë për procedurë të realizuar në thirrje gojore nga Institucioni nacional dhe për blerje të akulloreve për nevojat e Lokalitetit të përmendur, në të cilën janë dorëzuar tri oferta, ndër të cilat edhe oferta për bashkëpunim nga ana e parashtruesit të denoncimit, me numër me datë 12.04.2019, mirëpo i njëjti nuk është zgjedhur por me datë 25.04.2019 ka marrë lajmërim se është zgjedhur ndërmarrje tjetër. (.....)
- I pakënaqur me zgjedhjen dhe përshkak të dyshimeve se ai si person juridik përjashtohet nga furnizimi me akullore në lokalitetin e përmendur, shprehi ankesë me akuzat e përmendura, në të cilën nga institucioni nacional ka marrë përgjigje se në rastin nuk bëhet fjalë për furnizime publike me furnizues të vetëm, por bëhet fjalë për shitje me komision.
- Parashtruesi dyshon se në procedurën e lëndës janë respektuar disa kritere për procedurën dhe vendimmarrje gjatë zgjedhje së ndërmarrjes, dhe se nuk i është bërë e qartë se me cilat baza ligjore është përjashtuar ndonjë prodhues dhe shitës të bënë shitje në lokacion të caktuar dhe të favorizohet një ndërmarrje, dhe gjatë asaj të kufizohet e drejta e ndërmarrjes tjetër për shtije të akulloreve në lokacionin e njëjtë, gjegjësishtë është bërë diskriminim dhe përjashtim të konkurentëve të prodhuesve tjerë, dhe kjo për qëllim të realizimit të interesit nga shitja (përqindje adekuate ose rabat), si benifit për Institucionin.
- Në lidhje me akuzat e njëjta të lëndës, deri tek Ministria e kulturës, ka qenë dorëzuar ankesë nga ana e avokatit nga, e vulosur me numrin e tyre arkivues me nr. UPP me datë 23.05.2019, Ministria gjatë veprimit të tyre kompetent për lëndën e formuar ka kërkuar të shprehet me shkrim Institucioni nacional me çka me datë 29.07.2019 iu është dorëzuar shprehja me shkrim e kërkuar me të cilën është sqaruar procedura e plotë e lëndës dhe është dorëzuar dokumentacioni i plotë për rastin. Pas bërjes që vëshgimit të përmbajtjes së shprehjes me shkrim së Institucionit nacional dorëzuar deri tek Ministria, KSHPK vërejtë së është me përmbajtje të njëjtë me shprehjen me shkrim e marrur nga Institucioni e cila është dorëzuar me kërkesë së KSHPK.
- Nga ana e institucoionit nacional publikc, me kërkesë së KSHPK është dorëzuar lajmërim me shtojcë dokumentacion i plotë, me të cilën informojnë se procedura e plotë për furnizim me akullore për nevojat e Lokalitetit -, nuk është realizuar si procedure për furnizime publike në përputhje me Ligjin për furnizime publike dhe e njëjtë nuk është e paraparë me Planin vjetor për furnizime publike të Institucionit nacional për vitin 2019. Finansimin për furnizimin me akullore është siguruar nga ana e Llogarisë për aktivitete vetfinansuese të Institucionit nacional, me saktësisht llogaria dhe dorëzuar nëpërmjet planeve kuartale deri tek Minstria e kulturës së RMV. Procedura për furnizim me akullore për nevojat e lokacionit, ka filluar me Vedimin nga data 19.04.2019, për formim të Komisionit për zgjedhje të ofertës më të volitshme për blerje të akulloreve për nevojat e Lokalitetit, miratuar nga ana e drejtorit të Institucionit nacional, në bazë të nenin 13 paragrafi 2 alinea 18 nga Statusi i Institucionit nacional. Në përputhje me Vendimit, Komisioni është duhur të vepron në drejtim të hapjes

së ofertave të dorëzuara nga distributorët, në prezence të përfqësuesve të tyre, me datë 19.04.2019 në hapsirat e Institucionit nacional.

Komisioni për zgjedhje është takuar me datë 19.04.2019, dhe ka konstatuar se janë dorëzuar tri oferta (nga ndërmarrjet: SHPKNJP, SHPKNJ dhe SHPK). Ofertat kanë qenë publikisht të hapura në prezencë të antarëve të Komisionit dhe të përfaqësuesve të autorizuar të ofert-dhënësve dhe është përgaditur procesverbal në të cilën janë të nënshkruar të gjithë të pranishmit. Me datë 23.04.2019 nga ana e Komisionit janë rishikuar tri ofertat, është përgaditur Raport dhe si ofertë më e volitshme është zgjedhur oferta nga SHPKNJP, me sqarim të dhënë për arsyet e bërjes së zgjedhjes të kësaj ndërmarrje, kurse deri tek pjesmarrësit tjerë janë dorëzuar informime. Kontrata për shitje me ndërmarrjen e zgjedhur është nënshkruar me datë 24.04.2019.

Në informimet për zgjedhjen e bërë janë dorëzuar ankesa nga ana e një ofert-dhënësi (.....), me datë 10.05.2019, e adresuar deri tek shërbimi juridik edhe deri tek UD Drejtori i Institucionit nacional kurse jo deri tek Komisioni për zgjedhje. Pas ankesës janë dorëzuar informime se në rastin bëhet fjalë për bashkëpunim komercial-afarist me ndërmarrjen/prodhuesin për shitje të produkteve të tyre – akullore në lokacionin e përmendur dhe se nuk bëhet fjalë për procedurë për furnizime publike të mallrave dhe shërbimeve të cilat i harxhon Institucioni nacional. Gjithashtu, në lidhje me kërcënimet e përmendura në ankesën e dorëzuar se për rastin do të informohet prokuroria dhe KSHPK, Institucioni nacional informon se të njëjtat i kupton si shtypje joshembëlluese dhe nënçmim dhe se të njëjtat janë drejtuar pa bazë dhe nuk kanë të ndikojnë në ndryshim të vendimit të marrur për zgjedhje.

Në bazë të gjendjes së këtyre të caktuar faktike, KSHPK konstaton se në lidhje me rastin konkret të lëndës është vepruar nga ana e institucionit nacional pas ankesës së dorëzuar nga parashtruesi i denoncimit si pjesmarrës i pakënaqur në procedurën e lëndës, kurse deri tek parashtruesi i denoncimit është dorëzuar informim se në rastin bëhet fjalë për bashkëpunim komercial – afarist me ndërmarrjen/prodhuesin për shitje të produkteve të saj – akullore në lokacionin e përmendur dhe se nuk bëhet fjalë për procedurë për furnizime publike të mallrave dhe shërbimeve të cilat i harxhon institucioni publik i lëndës. Duke pasë parasysh të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi
Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: J. C., këshilltarë
Miratoi: S. P. D., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ KORRUPTIONIT**
Zëvendës-Kryetarë: Shemshi Sallai